

D E K R E T
Nr.7465, datë 31.1.1991

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7373, DATË 8.5.1990 "PËR NDËRMARRJET"

Neni 1

Në ligjin nr.7373, datë 8.5.1990 "Për ndërmarrjet" bëhen këto ndryshime:

1. Neni 14 ndryshohet si vijon:

"Veprimtaria e ndërmarrjes shtetërore organizohet, drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga organi përkatës.

Drejtori mban përgjegjësi për të gjithë veprimtarinë e ndërmarrjes".

2. Pas nenit 14, shtohet neni 14/a me këtë përmbajtje:

"Nuk i lejohet drejtorit që ta kalojë ndërmarrjen shtetërore në private".

3. Pas nenit 14/a, shtohet neni 14/b me këtë përmbajtje:

"Kalimi i ndërmarrjes shtetërore në ndërmarrje private bëhet sipas rregullave të caktuara me ligj të veçantë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.